

JANI SOTA

**ASPEKTE NGA MASIVIZIMI I SHKOLLËS
NË RRETHIN E FIERIT
(1946-1960)**

Vitet e para të pasluftës, si për gjithë shoqërinë shqiptare ishin të vështira edhe për popullsinë dhe bashkësinë arsimore fierake. Kjo ishte edhe periudha kur u hodhën bazat e një sistemi të ri arsimor. Pjesë e ndryshimeve të përgjithshme janë padyshim edhe direktivat rajonale të vërejtura në fushën e masivizimit të shkollës, që meritojnë vëmendje dhe interes.

*

* *

**Masat e para për zhvillimin
e arsimit fillor e 7-vjeçar**

Masivizimi i shkollës parakupton zgjerimin dhe fuqizimin e arsimit fillor, si hallka më e përhapur për kohën dhe shndërrimin e tij në arsim të detyruar. Nga zbatimi real i këtij arsimit kushtëzohej vetë ecuria e kategorive më të larta shkollore.

Për të ardhur në sanksionimin e të drejtës së arsimit nëpërmjet një ligji që e garantonte, u kalua nëpërmjet një faze përgatitore që u shtri nga viti 1945 deri në gushtin e vitit 1946, kur Kuvendi i Shqipërisë, njëherazi me Ligjin e Reformës Arsimore aprovoi edhe Ligjin mbi Arsimin Fillor të Detyrueshëm¹.

Përpjekje të shumta për shtrirjen e arsimit fillor, u bënë që në vitin 1945, duke kapërcyer vështirësi të mëdha. Në kuadrin e rindërtimit, u bë edhe meremetimi i shkollave të shkatërruara si dhe ndërtimi i shkollave të reja, që në shumicën e tyre ishin shkolla fillore.

Para organeve të arsimit, pushtetit lokal dhe mësuesve, dolën pengesa e vështirësi si: mungesa e lokaleve shkollore, e kuadrin arsimor, e teksteve dhe bazës materiale-didaktike. Gjithashtu, në punën e shkollës u ndeshën edhe koncepte e qëndrime patriarkale, si: “Ç’na duhet shkolla”,

¹ Eriketa Kambo, *Arsimi në Shqipëri 1945-1960*, Tiranë: 2005, f. 45.

“*Se shkolla nuk është për vajza*” etj. Këtyre koncepteve e praktikave të vjetra, iu kundërvunë thëniet progresiste të kohës, si: “*Sa më shumë bukë, sa më shumë kulturë për popullin*”, “*Asnjë analfabet në Shqipëri...*”, “*Të çojmë dritën e dijes e të kulturës në të gjitha skajet e vendit*”², etj.

Në këtë kontekst, duhet parë edhe ngritja e një sërë shkollash në çdo skaj të rrethit të Fierit. Mbështetur në udhëzimet e dikasterit të arsimit iu bë thirrje të gjithë atyre që kishin qenë mësues, apo atyre që dinin shkrim e këndim, që të mobilizoheshin dhe të punonin vullnetarisht si mësues në shkollat e rrethit. Mbi këtë bazë u mor vendimi që “... *çdo katund të ketë shkollën e vet*”³. Duhet thënë se, me gjithë vështirësitë dhe pengesat, populli përkrahu dhe mbështeti hapjen e shkollave. Ai ndihmoi pa rezerva si në sigurimin e lokaleve, ashtu edhe të bazës materiale etj. Popullsia arsimdashëse fierake, liroi shtëpitë për lokale shkollore, “... *edhe dhomën e vetme që kemi për familjen jemi gati ta bëjmë shkollë*”⁴ shpreheshin fshatarët në fshatin Pojan.

Në historikët e shkollave dhe të fshatrave, kudo gjen shprehjen, se “... *hapja e shkollës është ngjarje e rëndësishme në historinë e fshatit tonë*”⁵. Jo rrallë ka ndodhur që brenda një viti shkolla ka lëvizur në disa shtëpi, duke zgjedhur atë që ishte më e përshtatshme. Problemet e shkollës si frekuentimi, furnizimi me dru zjarri ndiqeshin pothuajse çdo ditë nga organet e pushtetit në vend. Fillimisht nuk kishte asnjë bazë materiale, por populli me ndihmë vullnetare bëri riparimin e lokaleve shkollore, qofshin edhe shtëpi private.

Gjatë vitit shkollor 1944-1945, si viti i parë i pasluftës, funksionuan në Nënprefekturën e Fierit 29 shkolla filllore, me 66 mësues dhe 2.250 nxënës, nga të cilët 947, ishin femra. U hapën 32 kurse kundra analfabetizmit, me 800 të rinj. Në shkolla u përfshinë djem e vajza nga mosha 7-10 vjeç në klasën e parë, dhe pak nga këta, në klasën e dytë⁶.

² Isa Halilaj, “Mbi sukseset e arritura në zhvillimin e arsimit dhe kulturës në rrethin e Kukësit”, në: *Arsimi Popullor*, Nr. 6, viti 1971, f. 159.

³ Fatmira Rama, “Reforma që i hapi rrugën shndërrimit socialist të shkollës”, në: *Revista pedagogjike*, Nr. 4, Tiranë: 1976, f. 157.

⁴ Muzeu Historik i Fierit, *Historiku i shkollave të rrethit të Fierit -1962* (Dorëshkrime nga drejtorët e shkollave).

⁵ Po aty.

⁶ Arkivi Shtetëror Vendor i Lushnjës (më tej: ASHVL), Fondi i Arsimit, Nr. 117, viti 1945, dos. 17, fl. 8-9.

Shkollat fillore, si pjesë e pandarë e sistemit arsimor "... u organizuan dhe funksionuan mbi bazën e Dekret-Ligjit Organik të Arsimit Fillor të vitit 1934. Pra shkolla fillore do të ishte pesëvjeçare"⁷. Për momentin, ky sistem, u vlerësua si më i mundshmi dhe më i përshtatshmi.

Më 21 dhjetor 1944, për arsimtarët e Qarkut të Vlorës, u zhvillua një konferencë. "Me këtë rast u hartua kuadri i arsimtarëve që harrijnë në 103 mësues të karrierës dhe 48 fillorista për 108 shkolla që sot janë hapur. ... Në shkollat e krahinave vazhdojnë edhe kurse analfabetike. Parashihet dhe për çeljen e 37 shkollave të tjera, porse mungon personeli arsimtar..."⁸.

Gjithashtu, gjatë periudhës maj-qershor 1945 "... janë mbajtur konferenca me natyrë politiko-arsimore në qendrat e Nënprefekturave Fier e Himarë dhe se rezultati i tyre ka qenë i kënaqshëm"⁹.

Në bazë të statistikave të kohës, për Nënprefekturën e Fierit, rezultojnë këto shkolla: në qytet, 1 shkollë foshnjore me 66 nxënës, ku 36 ishin femra, 2 shkolla fillore, me 628 nxënës gjithsej (303 femra); në qendër (Mbrostar, Qenas, Grecalli, Radostinë, Urë-Guri, Portez, Mujalli dhe Zhupan), 8 shkolla me 442 nxënës (191 femra); në zonën e Semanit (Seman, Kolkondas, Shënpjetër, Sinanbelli dhe Dërmenas) me 462 nxënës (192) femra; në zonën e Pojanit (Pojan, Frakull, Peshtan, Kafaraj, Ferras dhe Bishan, 6 shkolla, me 294 nxënës (112 femra); në zonën e Zharrëzës (Zharrëz, Kuqar, Rërës, Kraps, Grize-Godesh, Sheqishte dhe Beline), 7 shkolla me 378 nxënës (133 femra)¹⁰.

Gjatë vitit shkollor 1945-1946, në Nënprefekturën e Fierit, funksiononin 39 shkolla fillore (tre ishin në qytet), ku u përfshinë 5.870 nxënës me një shtesë rreth 46% në krahasim me vitin shkollor 1938-1939¹¹. Pjesëmarrja në shkollë ishte e kënaqshme, por jo e mjaftueshme, sepse jashtë shkollës, mbeteshin ende mjaft fëmijë. Në arsimin fillor, në shkollë nënprefekturë, rezultonte, që nga nxënësit e regjistruar vijonin rregullisht shkollën vetëm 5.276 fëmijë, d.m.th. 11% e tyre nuk e ndiqnin shkollën¹².

⁷ Po aty, fl. 4.

⁸ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi: Presidiumi i Kuvendit Popullor (1945-1991) Nr. 489, viti 1945, dos. 132, fl. 95.

⁹ Po aty, fl. 122.

¹⁰ Po aty, fl. 13-14.

¹¹ ASHVL, Fondi 117, viti 1945, dos. 64, fl. 3.

¹² Historiku i arsimit në rrethin e Fierit, Kabineti Pedagogjik Fieri, 1980, f. 131.

Të specifikuar për shkollat e fshatit dhe ato të qytetit, të dhënat nga statistikat e ndryshme kanë diferenca të theksuara. Në qytet ndiqnin rregullisht shkollën 94% e fëmijëve, kurse për fshatin kjo përqindje ulej në 86,5 të tyre¹³. Arsyet ishin nga më të ndryshmet. Përveç mungesës së godinave, të bazës materiale dhe të kuadrit, në vijimin e rregullt të nxënësve, ndikonin negativisht edhe vështirësi të tjera, si largësia dhe pozicioni i papërshtatshëm i mjaft shkollave të ndërtuara para lufte, mungesa e mjeteve të komunikacionit etj.

Gjithashtu, vepronin me forcë edhe shumë faktorë subjektivë. Rëndësia e arsimit nuk kuptohej njëllë nga të gjithë prindërit, sidomos nga ato të fshatit. Kështu, mësimi, mendohej si i domosdoshëm për djalin, por jo aq i rëndësishëm për vajzën.

Vitet e para të pasluftës, deri në Reformën Arsimore, u karakterizuan nga përpjekjet e popullsisë dhe sidomos të mësuesve, për zgjerimin e arsimit fillor me ritme të shpejta. Për ngritjen e shkollave fillore dhe të kurseve kundër analfabetizmit, mësuesit dhe aktivistët e organizatave të ndryshme shoqërore, kapërcyen shumë pengesa dhe vështirësi.

Mbresëlënëse, ishin përpjekjet e intelektualëve, rinisë e mësuesve në të gjithë vendin dhe, si pjesë e tyre edhe ato të mësuesve të zonës së Fierit, për hapjen e shkollave të reja, ndërtimin dhe rindërtimin e godinave shkollore, si në Boçovë, Belinë, Shterpas, Sula, Pishi-Poro, Dukas dhe Grykë¹⁴. Për t'u shënuar, është fakti se, u morën masa të shpejta, në përgatitjen e mësuesve për nevoja të ngutshme të shkollës. U përgatitën shumë mësues në qendër dhe në bazë, për shkollat fillore dhe për kurset kundër analfabetizmit.

Në korrik të vitit 1946, Ministria e Arsimit, hapi kursin pedagogjik, pranë Institutit Femëror të Tiranës, ku morën pjesë 400 pjesëmarrës nga i gjithë vendi. Mësimet vazhduan deri më 18 tetor. Nga rrethi i Fierit ndoqën kursin Katina Kristuli, Kozma Ikonomi, Jorgjie Papa, Nedret Vrioni, Luan Bajo, Ajet Kurti, Nazif Kurti, Kristaq Dane etj¹⁵. Një pjesë e mirë e tyre, vazhduan studimet me korrespondencë, në shkollën pedagogjike.

Në fund të vitit 1946, si rezultat i masave të ndërmarra nga Qeveria dhe komuniteti në aspektin financiar e material për Nënprefekturën e

¹³ *Po aty.*

¹⁴ *AQSh*, Fondi 489, viti 1946, dos. 24, fl. 89. Lista e shkollave të reja që janë ngritur nëpër katundet e N/Prefekturës Fier. Shkollat e reja të katundeve (të planit).

¹⁵ *Po aty.*

Fierit, në përgjithësi, godinat shkollore ekzistuese u rimëkëmbën dhe u ndërtuan shkolla të reja, duke ndihmuar për plotësimin e nevojave të arsimit.

“Rëndësia që i asht dhanë Arsimit, - thuhet në një dokument të Ministrisë, - na del nga vetë fakti që numri i tyre gati asht tre-fishuar gjatë periudhës të mbas çlirimit; p.sh. me 1934-40 kanë qenë të çelura 59 shkolla në tërë Prefekturën kurse sot kanë harritun të çelen 166 shkolla. Në këtë shifër përfshihen edhe 3 foshnjore në Qëndër e Fier dhe një në Himarë si dhe dy kopshte fëmijësh një në Qëndër dhe një në Himarë.

Janë ndërtuar 48 shkolla të reja të ndara në këtë mënyrë: 14 në Fier, 17 në Mallakastër, 1 në Qëndër, 4 në Kot, 10 në Llakatund dhe dy në Himarë. Janë ngritur karabina edhe 30 shkolla të tjera të djegura ose të shkatërruara nga okupatori dhe tradhëtarët dhe mos plotësimi i tyre ka ardhur nga mungesa e materjalit dhe e teknikëve”¹⁶.

Një rol të rëndësishëm për evidentimin e gjendjes ekzistuese të arsimit në Fier, si dhe në fshatrat përreth tij, për zgjidhjen e problemeve në këtë fushë, luajtën organet shtetërore vendore. *“Për planifikimin e planit do të japin një ndihmë të madhe Këshillat arsimore të N/Prefekturave, - thuhet në një dokument të kohës, - dhe përgjegjësit e caktuar për kontrollimin dhe ndjekjen e afërt të ngrehjes së ndërtesave”¹⁷.* Po në këtë dokument citohet: *“Kudo që shikohet se puna çalon të kërkohet ndihma e të gjitha organeve, të cilat kanë direktiva të veçanta nga qendrat e tyre që të mobilizojnë popullin për ngrehjen e ndërtesave shkollore”¹⁸.*

Me daljen e ligjit, në gushtin e vitit 1946, u rritën shanset për zgjerimin dhe fuqizimin e arsimit fillor. Mbi bazën e tij vihej në zbatim *“... në të gjithë shtetin arsimi fillor i detyrueshëm për të gjithë (djem e vajza) prej moshës 7 vjeç. Në lidhje me këtë – do të thuhej në ligj – duhet të shkojnë në shkollat fillore dhe të gjithë fëmijët në moshën 8, 9 dhe 10 vjeç që gjer më sot nuk kanë mësuar në shkollë. Arsimi është i detyrueshëm gjer në fund të moshës shkollore. Arsimi fillor i detyruar jepet falas për të gjithë dhe kryhet në shkollat fillore të çelura nga shteti”¹⁹.*

Në vitin arsimor 1946-47, kur ligji i detyrimit shkollor filloi të zbatohet në të gjithë vendin, u rrit shkalla e përfitimit nga kjo kategori shkollore. Procesi ishte i vështirë dhe në fillimet e tij u deshën të

¹⁶ Po aty.

¹⁷ ASHVL, Fondi 117, viti 1946, dos. 86, fl. 27.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Gazeta Zyrtare e RPSH, Nr. 85, Ligji Nr. 28, dt. 17.8.1946.

përballohen, krahas mungesave në bazën materiale apo të kuadrit mësuesor edhe, vështirësi të natyrës subjektive. Shpesh nuk u kuptuan dhe u zbatuan drejt të gjitha nenet e ligjit, veçanërisht gjatë regjistrimit të fëmijëve, kur u përfshinë nxënës nën moshë apo mbi moshën shkollore që ai parashikonte.

Me gjithë vështirësitë, statistikave e kohës për rrethin e Fierit flasin për një rritje të numrit të shkollave. Në vitin shkollor 1946-1947, në të gjithë rrethin e Fierit numëroheshin 79 shkolla fillore me 3.050 nxënës dhe 102 mësues, 8 kopshte fëmijësh me 403 fëmijë dhe 11 edukatore, si dhe funksionuan 87 kurse kundra analfabetizmit²⁰.

Të gjitha këto tregojnë se, ishte fituar deri diku një përvojë, ishin hedhur hapat e para drejt organizimit të një pune më të studiuar për arsimimin e mëtejshëm të komunitetit fierak. Por hapi më konkret që, hapja dhe zgjerimi krahas shkollave fillore dhe i shkollave unike, si një kërkesë dhe dëshirë e këtij komuniteti. Zgjerimi i arsimit fillor e mundësonte këtë.

Shkollat unike, si shkolla para të mesme, ose gjysmë të mesme e të veçuara nga shkollat fillore, nuk qëndruan gjatë me këtë emërtim e mënyrë funksionimi. Reforma Arsimore përcaktoi që arsimin fillor 4-vjeçar t'i shtoheshin edhe 3 vjet të shkollës unike e të emërtoheshin shkolla 7-vjeçare. Për efekt studimi shkollën 7-vjeçare do ta trajtojmë së bashku dhe në vazhdimësi me filloren, ashtu siç ka funksionuar realisht.

Shkollat unike, siç e kemi përmendur edhe më lart, u ngritën mbi bazën e kryerjes së shkollës fillore. Afati i kryerjes së saj ishte 3-vjeçar dhe në mbarim të saj pas provimeve të shtetit, nxënësit pajiseshin me dëftesën e semimaturës. Si rregull, shkollat 7-vjeçare në rrethin e Fierit u hapën aty ku shkollat fillore siguronin numrin më të madh të nxënësve dhe me mundësi për tërheqjen edhe të nxënësve të shkollave fillore më të afërta. Kështu, në vitin shkollor 1947-1948, shkollat unike për herë të parë funksionuan në qytet (Fier) tre shkolla. Numri i nxënësve në këto shkolla arrinte në 100 nxënës gjithsej dhe 6 mësues²¹.

Në vijueshmërinë e shkollave të para unike, veç dëshirës së mirë, vështirësitë e mangësitë ishin mjaft evidente. Mungonte kuadri i nevojshëm, veçanërisht ai i arsimuar, mungonin godinat dhe baza materiale e didaktike, pati mungesa të theksuara tekstesh mësuesore aq sa

²⁰ ASHVL, Fondi 130, viti 1947, dos. 65, fl. 6-7.

²¹ Po aty, fl. 13-14.

nxënësit qenë të detyruar të shkruanin fjalët e diktuar nga mësuesit. Është fakt se entuziazmit për hapjen e shkollave unike nuk iu përgjigjën dot me plotësimin e kontingjenteve të nxënësve. U hezitua shumë në mosdërgimin e vajzave në shkollë, thjesht për koncepte e mentalitet konservator e patriarkal.

Në vitet e mëvonshme, në rrethin e Fierit, të gjitha shkollat fillore që nuk arritën të bëhen 7-vjeçare (cikël i lartë), u grupuan dhe u drejtuan nga shkollat 7-vjeçare me një drejtor, këshill pedagogjik dhe rreth metodik. Kjo mënyrë organizimi dhe funksionimi ka patur anët e mira nga pikëpamja e administrimit dhe e kualifikimit të kuadrit mësues. Realisht, vëmendja e drejtuesve të arsimit në rreth, u përqendrua më tepër në ciklin e lartë se sa në bazën e shkollimit, në shkollën fillore. Ky nënvleftësim, u shfaq në disa drejtime: *së pari*, shkolla fillore e humbi deri-diku pavarësinë tradicionale dhe *së dyti*, në këtë hallkë kryesore të arsimit, dikur me më shumë kuadër normalist, për shkak të zgjerimit e mosplotësimit dot me kuadrin e mjaftueshëm, u mbush me kuadrin pa arsim përkatës. Thithja në ciklin e lartë, të të gjithë mësuesve më të mirë e me arsim përkatës nga shkolla fillore, uli cilësinë e kësaj të fundit.

Në raportin e datës 16.VII.1948, përpiluar nga Seksioni i Arsimit “Mbi zhvillimin e punës arsimore”, Nr. 14/1, do të thuhej, se: “...në rrethin e Fierit gjatë vitit shkollor 1947-1948, kanë funksionuar 115 shkolla gjithsej, nga të cilat 4 shkolla shtatëvjeçare, me një fuqi mësimore 170 veta, nga të cilët 149 janë të karrierës si dhe u regjistruan 6750 nxënës gjithsej”²².

Për sa i takon detyrimin të nxënësve për të vijuar shkollën, pavarësisht nga puna dhe masat e marra nga drejtuesit e arsimit, ai linte për të dëshiruar. Kjo shfaqej në mosrealizimin e numrit të nxënësve që duhet të ishin në shkolla, sipas planit të parashikuar. Kjo u pasqyrua qartë në këtë raport, ku theksohej: “... se kemi patur disa të meta mbasi ky nuk është zbatuar në të gjitha shkollat në kohën e duhur, kjo e metë ka rrjedhur nga se problemi i detyrimit shkollor nuk është kuptuar mirë nga ana e mësuesve ashtu edhe nga populli. Një e metë tjetër që ka penguar moszbatimin e detyrimit shkollor në kohën e duhur ka qenë edhe ajo e listave emërore të nxënësve të detyruar që nuk ka qenë e plotë në bazë të

²² Po aty, viti 1946, dos. 87, fl. 36.

*regjistrave themeltar dhe realitetit, bile në disa shkolla në fillim kanë munguar krejt*²³.

Në shumë shkolla 7-vjeçare, veçanërisht në ato të qendrave të vogla dhe të fshatrave, pothuajse asnjëherë nuk u arrit numri i mjaftueshëm i nxënësve për këtë kategori arsimore. Me gjithë përpjekjet e organeve vendore, kapaciteti i rrjetit të shkollave 7-vjeçare nuk u shfrytëzua sa duhej. Në tërheqjen e nxënësve në shkollat 7-vjeçare ndikuan para së gjithash, të njëjtët faktorë objektivë që vepruan edhe për arsimin fillor, si: kushtet e vështira ekonomike të komunitetit, sidomos atij të fshatit, largësia e madhe e shkollave etj. Të njëjtat dukuri, shfaqen në të gjithë rrethin e Fierit, veçanërisht në zonën e Mallakastrës, por për ato më të prapambeturat, më shpesh ishte ajo e angazhimit të gjerë të fëmijëve të klasave më të larta në punën e bujqësisë²⁴. Gjithashtu ky problem qëndronte edhe për shtresat e varfëra të qytetit të cilat ishin të detyruara të fusnin fëmijët e tyre në punë²⁵.

Mentaliteti i fortë patriarkal ishte një tjetër pengesë e madhe për përfshirjen sa më shumë të fëmijëve në kategorinë e arsimit 7-vjeçar dhe në veçanti të vajzave. Kështu në Mallakastër, në 6 shkolla të hapura (Ballsh, Cakran, Beline, Luare, Vlosh, Çorrush), nga 167 nxënës të planifikuar për të ndjekur klasat e pesta për vitin shkollor 1948-1949, u regjistruan vetëm 74, prej të cilëve vetëm 4 ishin vajza, kurse në klasat e gjashta mësonin gjithsej 6 vajza²⁶.

Në vitin shkollor 1948-1949 rrethi i Fierit kishte 111 shkolla fillore me 11.638 nxënës gjithsej, nga të cilët përfituan 8.788 nxënës duke realizuar planin vetëm 79% dhe 5 shkolla 7-vjeçare me 533 nxënës të regjistruar gjithsej por që e fituan atë 412 nxënës ose 77% e tyre²⁷. Kuadri mësimor efektiv që jepte mësim rregullisht përbëhej nga 211 mësues, nga të cilët 8 mësues jepnin mësim në shkollat 7-vjeçare²⁸.

Lidhur me kalueshmërinë e nxënësve në fund të vitit shkollor, rezultonte 71,6% në shkallë rrethi. Përqindja e ulët e kalueshmërisë sipas raportit të Seksionit të Arsimit të rrethit të Fierit, lidhej me disa pengesa: “a) *Moszbatimi i detyrimit shkollor në disa shkolla Dukas, Kuqar,*

²³ *Po aty*, viti 1948, dos. 45, fl. 2.

²⁴ *Po aty*, fl. 4.

²⁵ *Po aty*, fl. 7.

²⁶ *Po aty*, viti 1949, dos. 70, fl. 1.

²⁷ *Po aty*, fl. 2.

²⁸ *Po aty*.

Seman, Dermenas, Suk dhe Kallm; b) Mungesa e fletoreve dhe teksteve të mësimit, të cilat nuk kanë arritur në kohën e duhur. Një e metë tjetër që nuk duhet lënë pas dore, ka qenë edhe kualiteti i shkumësit që është përdorur në shkollë”²⁹.

Duhet theksuar fakti se, si për shkollat fillore ashtu edhe për ato 7-vjeçare, rezultonte se niveli i përparimit të nxënësve në përgjithësi ishte i ulët. Mungesa e kuadrit mësues të përgatitur, ishte një nga pengesat kryesore në drejtim të rritjes së cilësisë së shkollës. Po kështu, mungesa e mjeteve mësimore dhe pajisjeve shkollore në përgjithësi bënin punën e vet.

Tab. 1³⁰

**Pasqyra e shkollave në Fier sipas viteve shkollore
(1944 - 1949)**

Viti	Shkolla Fillore			Shkolla 7-vjeçare		
	Nr. i shkoll.	Nxënës	Mësues	Nr. i Shkoll.	Nxënës	Mësues
1944-1945	54	3.230	80	-	-	-
1945-1946	95	5.870	102	-	-	-
1946-1947	105	6.230	134	-	-	-
1947-1948	111	6.650	170	4	100	6
1948-1949	115	7,180	203	5	280	8

Për të përmirësuar gjendjen u morën masat për tërheqjen e sa më shumë fëmijëve në shkollë. Rëndësi të veçantë në këtë proces, pati Dekretligji i shtatorit të vitit 1949, “Mbi disa ndryshime e shtesa në ligjin e vitit 1946”³¹.

Zbatimi i masave administrative nga pushteti vendor bëri që në të gjithë rrethin e Fierit, të shtohet numri i nxënësve që vijonin shkollën fillore rregullisht. Por një problem po aq i mprehtë për shumë kohë mbeti, tërheqja e mjaftueshme e nxënësve në përputhje me mundësinë që ofronte arsimit 7-vjeçar. Në shumë shkolla 7-vjeçare, veçanërisht në qendrat e vogla dhe të fshatrave, pothuajse asnjëherë nuk u arrit numri i mjaftueshëm i nxënësve për këtë kategori arsimore. Me gjithë përpjekjet e organeve shtetërore të rrethit kapaciteti i rrjetit të shkollave 7-vjeçare, nuk u shfrytëzua sa duhej. Që në gushtin e vitit 1949, Ministria e Arsimit,

²⁹ *Po aty*, dos. 64, fl. 7.

³⁰ *Po aty*, viti 1959, dos. 322, fl. 1-11

³¹ *AQSh*, Fondi 511, viti 1949, dos. 129, fl. Dekretligji Nr. 730, dt. 5.9.1949. Mbi disa shtesa e ndryshime në Ligjin Nr.281, dt. 17.8.1946. Mbi arsimin fillor të detyruar.

për të evituar rastet e mbylljes në disa fshatra të shkollave, për shkak të numrit të pakët të nxënësve do të udhëzonte që, “... *seksionet e arsimit, drejtoritë e shkollave në bashkëpunim me organizatat e masave duhet të axhitonin në forma të ndryshme që të shkonin në klasat e 5, 6, 7 sa më shumë nxënës*”³².

Në vitin shkollor 1949-1950, në rrethin e Fierit u rrit numri i shkollave fillore dhe atyre 7-vjeçare. Kjo e fundit arriti në 9 shkolla 7-vjeçare me 721 nxënës³³. Kuadri arsimor për gjithë rrethin përbëhej nga 284 mësues për filloren, 36 për 7-vjeçaren, pra gjithsej 320 mësues. Detyrimi shkollor u realizua në masën 85%³⁴.

Në tërheqjen e nxënësve në shkollat 7-vjeçare, vijuan të ndikonin negativisht të njëjtët faktorë objektivë që vepruan edhe në arsimin fillor si, largësia e madhe e shkollave, në disa raste, terreni i thyer, kushtet e vështira ekonomike të popullsisë, veçanërisht në fshat etj. Kjo gjendje, pasqyrohej në raportin e Seksionit të Arsimit, ku theksohej se: “... *nxënësit e larguar nga shkolla u përkasin shtresave të varfëra të cilat nuk janë në gjendje t'i plotësojnë kushtet për të frekuentuar mësimin*”³⁵.

Për vitin shkollor 1950-1951, në rrethin e Fierit, numëroheshin 113 shkolla fillore gjithsej (6 shkolla në qytet) me 11.468 nxënës gjithsej (1.186 nxënës në qytet) si dhe 12 shkolla 7-vjeçare gjithsej (4 shkolla në qytet) me 895 nxënës gjithsej (532 nxënës në qytet)³⁶. Kuadri arsimor për gjithë rrethin përbëhej nga 294 mësues gjithsej, për filloren (34 mësues në qytet) si dhe 44 mësues gjithsej për 7-vjeçaren (21 në qytet)³⁷.

Detyrimi shkollor, edhe për këtë vit nuk u realizua. Për këtë qëllim, afatet e regjistrimit në zonat problematike u shtynë. Kështu, në raportin mbi punën për vitin shkollor 1950-1951, në rrethin e Fierit, do të theksohej, se: “... *deri më 26 gusht ishin regjistruar 90% e nxënësve pa bërë më parë verifikimin e listave. Një mungesë e tillë do të tërhiqte vëmendjen, solli si konstatim gabime në listat e detyrimit, të cilat më poshtë po i përmendim:*

a) *Në listat e detyrimit shkollor, që u nxorën nga arsimtarët në prillin e kaluar figuronin 140 nxënës që ishin më tepër se tre kilometra*

³² *Po aty*, viti 1949, dos. 24, fl. 17.

³³ *ASHVL*, Fondi 130, viti 1950, dos. 125, fl. 1.

³⁴ *Po aty*.

³⁵ *Po aty*, viti 1951, dos. 125, fl. 1.

³⁶ *Po aty*, fl. 14.

³⁷ *Po aty*.

larg shkollës. Të tillë nxënës ka patur në katundet Peshtan, Cakran, Çorrush, Kreshpan etj.

b) Në listat e detyrimit shkollor figuronin nxënësit e datëlindjes 1943, por që në realitet ishin më të vegjël korrigjimet e të cilave nuk u bënë për të gjithë, por vetëm për një pjesë, kështu që u regjistruan edhe nxënësit që nuk kanë kondita për shkollë.

c) Por edhe nga ana e Seksionit në hartimin e listave qenë bërë gabime duke i shtuar shifrat e një shkolle më tepër nga sa kishte planifikuar vetë shkolla.

Si rrjedhim del që numri i nxënësve të regjistruar në fillim të vitit ka qenë 12.034 dhe në fund të tremujorit të parë arriti 11.892 d.m.th. 172 nxënës më pak, pjesa më e madhe e të cilëve që është shpërngulur nga rrethet e tjera dhe një pjesë e vogël qenë regjistruar dy herë, mbasi figuronin në dy shkolla. Kjo shifër lëvizti edhe gjatë tremujorit tjetër, por vetëm në drejtim të lëvizjes së nxënësve, kështu që realizimi i detyrimit në fillore u arrit vetëm 97%³⁸.

Gjatë kësaj periudhe, me gjithë dobësitë zgjerimin më të mirë brenda arsimit 7-vjeçar e pati arsimit fillor. Duhet thënë se ndërtimet e reja u përqendruan në fshatrat më të thella e të prapambetura të rrethit, si në Kalenjë, Drizar, Varibobë, Dames, Metaj, Hamil etj.³⁹ Kjo lidhej me një prapambetje më të madhe të fshatrave në krahasim me qytetin e Fierit, madje me vetë ndryshimet midis fshatrave fushore dhe atyre kodrinore.

Si rezultat i bashkërendimit të veprimtarisë së pushtetit lokal me organizatat e masave, si dhe me iniciativën dhe kontributin e vetë popullit, u arrit që në vitin 1952, arsimit fillor të shtrihej pothuajse në të gjithë territorin e rrethit. Në të u tërhoqën rreth 97,84 për qind e fëmijëve të moshës shkollore⁴⁰. Pas këtij viti, procesi i zgjerimit të shkollave të reja fillore eci më ngadalë. Veprimtaria e seksioneve të arsimit u fokusua në drejtim të përmirësimit të bazës materiale të shkollave dhe fuqizimin e arsimit fillor dhe atij 7-vjeçar.

Zgjerimi i kategorive të ndryshme arsimore dhe rritja e interesit të masave dhe të shoqërisë për shkollën, bënë të mundur përgatitjen dhe zbatimin gradual të Ligjit “Mbi arsimin 7-vjeçar të detyruar”, që u aprovua në qershorin e vitit 1952. Mbi bazën e tij, arsimin 7-vjeçar do ta

³⁸ Po aty, fl. 2-3.

³⁹ Po aty, viti 1952, dos. 32, fl. 1-2.

⁴⁰ Po aty, fl.2.

ndiqnin të gjithë nxënësit e nxënëset që përfundonin shkollën fillore në qytet dhe fshatra.

Mbi bazën e një studimi në shkallë vendi, Ministria e Arsimit në bashkëpunim me Komitetin Ekzekutiv të Rrethit Fier, përcaktuan fillimisht shkollat që do t'i nënshtroheshin arsimit 7-vjeçar, të detyruar për vitin e parë të zbatimit të ligjit. Si të tilla, për vitin shkollor 1952-1953, u përcaktuan shkolla 7-vjeçare Nr.1, Nr.2, Nr.6, të qytetit, si dhe shkollat 7-vjeçare të fshatrave Mbrostar, Seman, Libofshë, Roskovec, Patos i Ri, Ballsh, Hekal, Cakran dhe Symize⁴¹. Përpjekjet për hapjen e shkollave të reja në qytet e fshatra si dhe pajisja deri diku e tyre me kuadro të mjaftueshëm ndikuan pozitivisht. Gjatë këtij viti shkollor, numri i shkollave fillore arriti në 116 gjithsej (6 shkolla në qytet) me 11.498 nxënës gjithsej (1.118 nxënës në qytet), kurse për shkollat 7-vjeçare shkonte në 13 gjithsej (4 në qytet) me 1.377 nxënës gjithsej⁴².

Për zbrërthimin e plotë të Ligjit dhe përcaktimin e masave konkrete që duheshin marrë, ndihmoi një udhëzim i posaçëm i Ministrisë së Arsimit, i dalë në qershor të vitit 1952. Nëpërmjet këtij udhëzimi u lihej detyrë drejtorive të shkollave 7-vjeçare, që të përgatisnin në kohë listat e nxënësve që detyroheshin të ndiqnin shkollën. Nga ana tjetër, mësuesit ishin të detyruar të njoftonin prindërit deri më 15 korrik, ndërkohë që komitetet ekzekutive të rretheve ku shtrihej arsimit 7-vjeçar duhej që deri më 25 qershor të çdo viti, të përgatisnin listat emërore të fshatrave, qyteteve dhe lagjeve e fshatrave periferike. Gjithashtu, ai shpengonte edhe masat për shkeljen e ligjit por tërhiqte vëmendjen se parapëlqej zbatimin vetëm për raste më tipike. "*Seksionet e arsimit, - gjithnjë sipas tij, - duhet të kërkojnë ndihmën e organizatave të masave për sqarimin e prindërve të fëmijëve për t'i bindur ata që t'i dërgojnë në shkollat 7-vjeçare me vullnet të plotë, në mënyrë që të evitohen masat ndëshkimore*"⁴³.

Me daljen dhe zbatimin e Ligjit të detyrimit shkollor, procesi hyri në një fazë të re më të lartë, duke u vënë mbi baza të organizuara⁴⁴. Megjithatë, problemi i shkëputjes së nxënësve nga shkolla, veçanërisht në fshat dhe i vajzave, vazhdonte të ishte i mprehtë. Në Mbrostar nga 139

⁴¹ *Po aty*, fl. 2.

⁴² *ASHVL*, Fondi 130, viti 1953, dos. 126, fl. 1.

⁴³ *Po aty*, fl. 2-3.

⁴⁴ *AQSh*, Fondi 511, viti 1952, dos. 32, fl. 9-10.

nxënës, vetëm 66 ishin femra, në Portez nga 57 nxënës, vetëm 30 ishin femra, në Sheq nga 91 nxënës, vetëm 47 ishin femra⁴⁵.

Një problem i mprehtë që ishte dhe mbeti evident edhe në këtë periudhë, ishte pakujdesia në hartimin e listave të detyrimit shkollor. Ky fenomen vërehej edhe në qytetin e Fierit, Patosit dhe Ballshit. Diferencat ishin evidente midis vetë fshatrave, qytetit dhe fshatit, midis djemve dhe vajzave. Faktorët më ndikues ashtu si dhe për arsimin fillor, mbeteshin niveli i ndryshëm i zhvillimit ekonomik e kulturor dhe sidomos mentaliteti më i prapambetur apo forca e zakonit. Kështu në qytet si dhe në fshatrat Seman, Libofshë, Roskovec, Patos i Ri, Ballshi, Hekali dhe Cakran, zbatimi i ligjit shënonte tregues relativisht të mirë (në masën 90%). Për fshatrat më të thella e të prapambetura si: në Kalenjë, Drizar, Varibobë, Damës, Metaj, Hamil etj., nivelet ishin minimale (në masën 15-30%) dhe akoma më të ulëta për vajzat⁴⁶. Megjithatë, Seksioni i Arsimit në rrethin e Fierit pranonte se: “... *Për dobësitë e këtyre shkollave ka qenë shkaku se problemi i regjistrimit nuk u kap seriozisht në këto shkolla; këtu ndihma e organizatave të masave mungoi krejt, por edhe drejtorët nuk ndoqën me seriozitetin më të madh, por e lanë zvarë deri sa më në fund arritën rezultatet e sipërme*”⁴⁷.

Në vitin shkollor 1953-1954, numëroheshin 119 shkolla fillore gjithsej (8 shkolla në qytet), me 11.313 nxënës gjithsej (980 nxënës në qytet), kurse numri i shkollave 7- vjeçare arrinte në 20 gjithsej (4 shkolla në qytet), me 3.119 nxënës gjithsej (971 nxënës në qytet)⁴⁸. Një vit më vonë, numri i shkollave fillore arriti në 123 gjithsej, kurse i shkollave 7- vjeçare në 25. Numri i nxënësve të regjistruar në shkollat fillore arrinte në 11.879 nxënës gjithsej, prej të cilëve 995 nxënës në qytet, kurse në shkollën 7-vjeçare, ky numër arrinte në 4.037 nxënës gjithsej, nga të cilët 1.015 nxënës në qytet⁴⁹.

Një dukuri negative mbeti përsëri krijimi i defiçiteve në raportin nxënës të regjistruar dhe atyre që përfundonin shkollat 7-vjeçare. Ashtu siç e kemi theksuar, përveç faktorëve social-ekonomik ndikuan “... *tek një pjesë e nxënësve mospërballimi me fuqinë mësimore si dhe një pjesë*

⁴⁵ ASHVL, Fondi 130, viti 1953, dos. 176, fl. 3.

⁴⁶ Po aty, Fondi 130, viti 1953, dos. 126, fl. 2-3.

⁴⁷ Po aty, viti 1955, dos. 113, fl. 13-14.

⁴⁸ Po aty, viti 1954, dos. 72, fl. 3.

⁴⁹ Po aty, viti 1955, dos. 84, fl. 4.

*ishin të largët (më tepër se 8 km) dhe më në fund një pjesë e tyre për arsye pune në familje*⁵⁰.

Duke bërë një bilanc të zhvillimeve arsimore në rrethin e Fierit, në vitet 1949-1956, ato mund të vlerësohen si vitet e zgjerimit të shkollave fillore dhe atyre 7-vjeçare. Kështu, nga 115 shkolla fillore dhe 5 shkolla 7-vjeçare, që kishte më 1948, numri i tyre më 1956, arriti përkatësisht në 125 shkolla fillore dhe 26 shkolla 7-vjeçare. Këto të fundit mundën të shtriheshin vetëm në qytet dhe fshatrat më kryesore që kishin shkolla fillore të konsoliduara. Aty, u tërhoqën rreth 90% e nxënësve që përfunduan arsimin fillor në qytet dhe rreth 33-35% e nxënësve të shkollave të fshatit⁵¹. Në zonat rurale ku përqindja ishte më e pakët, për tërheqjen e nxënësve u rrit sasia e bursave dhe e konvikteve.

Pavarësisht nga masat e marra nga organet shtetërore, treguesit mbetën të ulët. Duhet theksuar se zgjerimi i shpejtë, deri në sforcim i kategorisë arsimore 7-vjeçare shumë shpejt çoi në diferencime të theksuara midis zhvillimeve sasiore dhe atyre cilësore. Ecuria e këtij procesi ilustron me evidencat statistikore, të mëposhtme:

Tab. 2⁵²

Pasqyra përmbledhëse e numrit të mësuesve dhe të nxënësve të shkollave të rrethit të Fierit në periudhën 1949 - 1956

Viti	Shkolla Fillore			Shkolla 7-vjeçare		
	Nr. i shkoll.	Nxënës	Mësues	Nr. i shkoll.	Nxënës	Mësues
1949-1950	109	9.640	284	9	721	10
1950-1951	114	11.656	315	13	895	20
1951-1952	115	11.892	278	16	820	26
1952-1953	116	11.489	296	18	1.377	31
1953-1954	119	11.313	302	20	3.119	35
1954-1955	123	11.879	323	24	3.037	38
1955-1956	125	12.630	340	26	3.330	76

Siç konstatohet në këtë periudhë, ishte ende i fortë fenomeni i diferencimit midis qytetit dhe fshatit si dhe midis vetë fshatrave të rrethit të Fierit. Me gjithë shtrirjen e mirë gjeografike të arsimit të detyrueshëm, ai nuk përfshinte të gjithë hapësirën në rreth dhe fëmijëve iu desh të ecnin

⁵⁰ AQSh, Fondi 511, viti 1954, dos.20, fl. 5.

⁵¹ ASHLV, Fondi 130, viti 1956, dos. 113, fl. 3.

⁵² Po aty, viti 1968, dos. 322, fl. 1-11.

me orë të tëra për të shkuar në shkollë. Prandaj, siç del nga dokumentet e kohës dhe kujtimet e bashkëkohësve, kërkesat për hapjen e shkollave të reja vazhduan edhe gjatë periudhës në vijim. Gjithashtu, zbatimi i ligjit vijoi të përballet me nevojën e investimeve të reja në rrjetin e institucioneve të arsimit 7-vjeçar dhe, sidomos me atë të shfrytëzimit të kapacitetit të atij ekzistues. Problem jo i pakët mbetej ai i sigurimit të kuadrit mësimor të nevojshëm dhe të kualifikuar si dhe ai i pajisjes më të mirë materiale-didaktike të kësaj kategorie shkollore.

Krahasuar me periudhat e mëparshme, arsimit 7-vjeçar shënon progres. Tipari dallues kryesor i zhvillimit sasior të tij ishte shtrirja edhe në zona të thella të rrethit. Ky zhvillim gjeti mbështetjen e masave arsimdashëse të Fierit. Gjatë periudhës 1955-1960 u përgatitën kontigjente të reja nxënësish për arsimin e mesëm, duke bërë të mundur edhe zgjerimin e kësaj hallke të sistemit arsimor.

Ritmet disi më të shpejta të shtrirjes e të zgjerimit të arsimit 7-vjeçar u vunë re gjatë viteve 1957-1958. Në rrethin e Fierit, u hapën 4 shkolla të reja të kësaj kategorie arsimit, duke e rritur numrin e përgjithshëm në 30, ndërsa ai i shkollave fillore shkoi në 129⁵³. Tregues pozitiv u arritën edhe në tërheqjen e nxënësve sidomos i atyre nga fshatra të zonave të thella të Mallakastrës.

Vetëm në vitin shkollor 1958-1959 u tërhoqën në konviktin e Fierit 78 nxënës nga këto zona⁵⁴. Shteti, nga ana e tij, çdo vit rriti numrin e bursave për këto kontigjente nxënësish. Në vitin 1960, shteti akordoi 23 bursa⁵⁵ për këtë konvikt për klasën e pestë, e kështu me radhë, vit pas viti, me gjithë rritjen e numrit të shkollave 7-vjeçare, ky konvikt u mbajt e u fuqizua më tej.

Një formë tjetër e shkollimit të fëmijëve në shkollat 7-vjeçare, ishte edhe dërgimi i tyre, në vendbanimet e të afërmeve ku kishte shkolla. Në këtë formë, në vitin 1958-1959, e vazhduan shkollën 24 nxënës, nga të cilët 15 në qytetin e Fierit, 4 në Ballsh, 2 në Levan, 2 në Seman dhe 2 në Libofshë⁵⁶. Kjo formë shkollimi që ishte shprehje e solidaritetit të popullit, u mbështet në ato vite nga organet e arsimit dhe ato të pushtetit në qendër e në bazë. Në vitin shkollor 1960-1961, numri i nxënësve që frekuentonin 40 shkollat 7-vjeçare, arriti në 5.648 nga 895 nxënës gjithsej

⁵³ *Po aty*, viti 1958, dos. 227, fl. 3.

⁵⁴ *Po aty*, viti 1960, dos. 294, fl. 21-23.

⁵⁵ *Po aty*.

⁵⁶ *Po aty*, viti 1959, dos. 268, fl. 13.

që kishte në këtë kategori shkolle në vitin 1950 ose 6.3 herë më shumë, me një rritje mesatare vjetore prej 15.8 për qind⁵⁷.

Ashtu si në kategoritë e tjera të arsimit, edhe në arsimin 7-vjeçar zhvillimet ishin të konsiderueshme. Ato krijuan kushte të përshtatshme që në vitet '60 të fillojë kalimi nga arsimi 7-vjeçar i detyruar, në atë 8-vjeçar. Zbatimi i arsimit të përgjithshëm dhe të detyrueshëm 7-vjeçar, ishte një hap përpara për ngritjen e mëtejshme të nivelit arsimor e kulturor të popullsisë në përgjithësi, dhe të brezit të ri në rrethin e Fierit, në veçanti.

Tab. 3⁵⁸

Pasqyra përmbledhëse e numrit të mësuesve dhe të nxënësve të shkollave të rrethit të Fierit në periudhën 1956 - 1960

Viti	Shkolla Fillore			Shkolla 7-vjeçare		
	Nr. i shkoll.	Nxënës	Mësues	Nr. i shkoll.	Nxënës	Mësues
1956-1957	128	11.030	353	27	2.980	121
1957-1958	129	13.214	336	30	3.984	147
1958-1959	130	1.286	370	32	3.980	162
1959-1960	130	13.483	402	35	4.450	193
1960-1961	130	14.293	433	40	5.648	237
1961-1962	131	15.387	452	40	8.509	265
1962-1963	132	16.437	492	42	7.412	327
1963-1964	135	17.368	543	45	7.875	348

Arsimi i mesëm i përgjithshëm

Pjesë e zhvillimeve arsimore në rrethin e Fierit ishin edhe ato në arsimin e mesëm. Shtrirja dhe konsolidimi i arsimit fillor, zgjerimi i arsimit 7-vjeçar, dëshira e madhe e popullsisë për arsimim dhe përpjekjet e kërkesat e vazhdueshme të saj drejtuar Qeverisë, bënë realitet çeljen e shkollës së parë të mesme të përgjithshme në qytetin e Fierit, më 1 shtator 1956⁵⁹.

⁵⁷ *Po aty*, viti 1961, dos. 316, fl. 19-21.

⁵⁸ *ASHVL*, Fondi 117, viti 1968, dos. 322, fl. 1-11.

⁵⁹ Jani Sota, *Gjimnazi "Janaq Kilica" në vite*, Tiranë: "Extra", 2005, f. 34.

Deri në vitin 1952, nevojat u plotësuan me dërgimin e kontigjenteve të planifikuara në shkollat e mesme jashtë rrethit. Që më 1945, u dërguan në Normalen e Elbasanit, Gjimnazin e Gjirokastrës dhe në shkollat e tjera të mesme së pari nxënësit ish-partizane, për të marrë vitet e fundit ose provimet e maturës. Po kështu më vonë u dërguan nxënësit e parë bursistë për shkollat e mesme nga prefektura e Vlorës⁶⁰ (Fier, Mallakastër, Himarë - J. S.) që ndoqën shkollat e mesme profesionale në Vlorë, Elbasan, Tiranë etj. Hapja e shkollës së mesme në vitin 1956, në Fier, krijoi kushte për përgatitjen e kuadrove e specialistëve të mesëm brenda rrethit.

Arsimi i mesëm i përgjithshëm u mbështet nga zgjerimi i hallkave të tjera të arsimit. Mundësi krijoi shtrirja dhe zhvillimi i arsimit 7-vjeçar në mesin e viteve 50-të. Deri në qershor 1960, Fieri kishte 113 kuadro vendas me arsim të mesëm e të lartë, dhe që në atë vit vazhduan shkollën e mesme e të lartë jashtë rrethit edhe 105 nxënës dhe 18 studentë⁶¹.

Shkollimi i mesëm brenda rrethit, ishte një mundësi më shumë për djemtë e vajzat fierake për t'u shkolluar e specializuar në shkollat e larta të vendit. Për arsimin e mesëm në Fier, tanimë ishte krijuar një kontigjent i mjaftueshëm nxënësish. Në vitet 1952-1956, kishin mbaruar klasën e shtatë rreth 320 nxënës⁶².

Në vitin shkollor 1959-1960, shkolla e mesme e përgjithshme "18 Tetori" numëronte 296 nxënës, prej të cilëve 95 vajza dhe një vit më vonë numri i nxënësve shkoi 381 nga të cilët 287 ishin femra. Në vitin 1960, në bankat e kësaj shkolle u përgatit matura e parë me 49 nxënës gjithsej, ku 24 ishin femra⁶³. Gjimnazi i Fierit në vitet 1956-1960, si e vetmja shkollë e mesme për rrethin, kontribuoi në radhë të parë për sigurimin e kontigjenteve të nxënësve në drejtim të arsimit të lartë, por edhe për përgatitjen e specialistëve të mesëm në disa prej degëve kryesore të ekonomisë në rreth dhe më gjerë.

Arsimi profesional dhe orientimi i tij, industrialo - bujqësor në rrethin e Fierit

Zhvillimi i ekonomisë në rrethin e Fierit nuk mund të bëhej, me ata pak teknikë e punëtorë disi të kualifikuar në periudhën e paraluftës. Për

⁶⁰ *Po aty.*

⁶¹ *Po aty.*

⁶² *Po aty.*

⁶³ *Po aty.*

këtë, që në vitet e para, u morën masat që synuan përgatitjen e kuadrit të nevojshëm teknik dhe të punëtorëve të kualifikuar.

Gjatë kësaj periudhe, për plotësimin e nevojave të prodhimit me punëtorë të kualifikuar, luajtën rol shkollat e ulta profesionale, ndonëse numri i tyre ishte i kufizuar e për rrjedhojë edhe numri i nxënësve që mbaronin ato ishte i pakët. Kështu, në vitin 1950 i mbaruan këto shkolla vetëm 78 nxënës⁶⁴.

Plani i parë pesëvjeçar (1951-1955), parashikonte ngritjen e një sërë veprash industriale dhe për rrjedhojë edhe një rritje të ndjeshme të numrit të punëtorëve të kualifikuar, që të ishin në gjendje të zotëronin teknikën e re të prodhimit.

Zgjidhja e këtij problemi, si për gjithë vendin, edhe në rrethin e Fierit, do të arrihej nëpërmjet përgatitjes së punëtorëve të rinj të kualifikuar në kurset profesionale, si dhe kualifikimin e perfeksionimin e punëtorëve ekzistues me anën e kurseve të posaçme me ndërprerje nga prodhimi, të kurseve pranë ndërmarrjeve, pa shkëputje nga prodhimi, si dhe me formën e patronazhit.

Kështu, në kurset profesionale me shkëputje nga puna, në Fier u përfshinë specialitetet: mekanik i përgjithshëm, mekanik riparues-axhustator, mekanik motorist-xhenerik, mekanizator i bujqësisë, specialist i agronomisë e të perime-kulturës etj.

Në Patos, për vetë specifikën që kishte kjo zonë, si zonë e naftës dhe e gazit, kurset funksionuan në specialitetet: shpim i puseve të naftës e të gazit, nxjerrje e naftës e gazit. Gjithashtu u përgatitën edhe punëtorë të kualifikuar, që do të punonin në fabrikën e zhveshjes së pambukut në Fier. Në to, morën pjesë nxënësit që kishin mbaruar filloren, si dhe ata që kishin mbaruar uniken⁶⁵.

Këto qendra industriale u shndërruan edhe në shkolla për përgatitjen e punëtorëve të kualifikuar si për nevojat e tyre, ashtu edhe për qendra e sektorë të tjerë të punës e të prodhimit. Kështu në Patos, komisioni i përbërë nga inxhinierë të kualifikuar, dha ndihmesë në ngritjen e një ofiçine ndërshkollore, duke u mbështetur në kërkesat e programet mësimore. Ky qe një hap i rëndësishëm drejt organizimit të shkollës profesionale. Kjo ofiçinë i shërbeu shumë kurseve profesionale, por edhe gjithë shkollave të qytetit të Fierit dhe të fshatrave përreth tij.

⁶⁴ *Po aty*, viti 1951, dos. 17, fl. 32.

⁶⁵ *ASHVL*, Fondi 117, viti 1951, dos. 146, fl. 17-21.

Në nëntor të vitit 1950, Këshilli i Ministrave, mori një vendim tjetër, sipas të cilit, për nevojat e Kombinatit të Naftës do të hapesh në Kuçovë një kurs 4 mujor me 100 punëtorë, si dhe 2 shkolla 2-vjeçare në Tiranë e në Vlorë, që do të përgatisnin 412 punëtorë të kualifikuar për nevojat e industrisë. Do të hapeshin gjithashtu, 3 kurse 6 mujore në Elbasan, Vlorë e Tiranë ku do të përgatiteshin për nevojat e Ministrisë së Ndërtimit, 100 punëtorë të kualifikuar.

Nga informacionet e asaj kohe, rezulton se nga ana e Dikastereve përkatës realizimi i planit të kurseve në total, paraqitet: kurse kualifikimi 73%, kurse prefeksionimi 75%, kurse 6 mujore 93% dhe shkolla 1 vjeçare 92%⁶⁶. Këto shifra flasin për mosrealizim të planit të kurseve, të cilat lidhen me shumë faktorë, siç janë: mosdetajimi i mirë i planit nga ana e dikastereve për ndërmarrjet e tyre varëse, mosrespektimi i afateve mbi hapjen e kurseve që ishin në plan.

Në vitin 1952 u hap kurs i veçantë për muratori, të cilin e ndoqën 50 veta. Në Vlorë, u hap po atë vit, kursi administrativ financiar dhe kursi për daktilografiste. Gjithashtu, rëndësi iu kushtua arsimit shëndetësor. Pas kurseve të viteve të para, për infermiere, nga viti 1951, filloi funksionimin, një kurs 9 mujor dhe më vonë në Vlorë, hapet edhe teknikumi mjekësor i natës. Po kështu, në kurse 1 ose 2 vjeçare të ngritura në qytete të tjera të vendit, si në Tiranë, Berat, Korçë etj., morën pjesë të rinj dhe të reja fierake e mallakastriote⁶⁷.

Kurset profesionale kishin një program të përafërt, me atë që zhvillohej në dy vitet e shkollave të ulëta profesionale. Puna mësimore mbështetej në planet dhe programet e hartuara nga dikasteri përkatës.

Fillimisht, kishte vështirësi, në sigurimin e teksteve, bazës materiale mësimore të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor dhe atij praktik etj. Më vonë, puna u përmirësua. Mësuesit dhe instruktoret, i përgatitnin vetë temat e mësimit sipas kërkesave të programit, i shpillofonin dhe ua jepnin nxënësve⁶⁸.

Gjithsesi, duhet theksuar se, masat e marra në rrugë shtetërore për përgatitjen profesionale të punonjësve, ndihma e organizatave shoqërore dhe dëshira e vetë punëtorëve për t'u aftësuar ndikuan pozitivisht në

⁶⁶ *AQSh*, Fondi 490, viti 1952, dos. 1294, fl. 22. Informacion mbi realizimin e planit të kurseve të kualifikimit e prefeksionimit për 6 mujorin e I-rë nga ana Dikastereve.

⁶⁷ *ASHVL*, Fondi 117, viti 1968, dos. 322, fl. 1-11.

⁶⁸ *Po aty*, viti 1951, dos. 146, fl. 17-21.

arritjen e rezultateve të para edhe në këtë fushë. Në ndërmarrjen e shpimkërkimit të Patosit, nga analiza që iu bë këtij problemi, për 6 mujorin e parë të vitit 1952, rezultoi se nga 7 kurse të planifikuara, ishin ngritur 8 të tilla, me 103 pjesëmarrës.

Në vitin 1954, nëpërmjet formave të reja të kualifikimit ishin kualifikuar ose perfeksionuar mbi 126 punëtorë në specialitete të ndryshme si saldator, kaldaista, traktorista, elektrikista, mjeshtra të shpimit, prodhimit, pastrimit e mirëmbajtjes së makinerive etj.⁶⁹

Zhvillimi i sektorit socialist të bujqësisë në rrethin e Fierit, kërkesat në rritje të NBSH-ve dhe SMT-ve bënë që, Ministria e Bujqësisë dhe organet partiake e vendore, t'i kushtojnë më tepër kujdes përgatitjes së punëtorëve të kualifikuar me anën e kurseve ekzistuese dhe kurseve të reja që zgjatnin nga 3-9 muaj. Kjo është e kuptueshme, kur dihet se rrethi i Fierit në atë kohë ishte një vend kryesisht agrar. Për këtë arsye, për përparimin e bujqësisë, në këto anë, gjatë kësaj periudhe, pranë NBSH-ve dhe SMT-ve u ngritën kurse agroteknike e zooteknike për të përgatitur punëtorë të kualifikuar për sektorë të ndryshëm të bujqësisë, si për mekanikë, traktoristë, autokombanierë, kultivonjës të bimëve të arave e të drurëve frutorë etj.

Përveç kurseve nacionale në Kavajë e Durrës, ku u përgatitën punëtorë të kualifikuar për bujqësi, në rrethin e Fierit u hapën kurse lokale kualifikimi dhe perfeksionimi. Kështu gjatë vitit 1954, në degën e bujqësisë funksionuan 9 kurse lokale, me 186 pjesëmarrës nga të cilat morën dëshmi kalimi 73 nxënës⁷⁰. Me qëllim që të nxitej pjesëmarrja e nxënësve në këto kurse, për të gjithë ata që nuk ishin në marrëdhënie pune, akordohej një bursë prej 3.200 lekësh⁷¹. Pjesa më e madhe e nxënësve ishin nga fshati apo me origjinë punëtore nga qyteti. Në të gjithë degën e bujqësisë, deri në fund të vitit 1954, u përgatitën 46 teknikë të mesëm dhe 287 punëtorë të kualifikuar⁷².

Në vitet e mëvonshme u rritën përpjekjet e organeve shtetërore, për kualifikimin dhe ngritjen e mëtejshme të nivelit profesional të punëtorëve. Gjithashtu ato ushtruan kontroll në kurset profesionale për të parë shkallën e frekuentimit dhe përparimit të pjesëmarrësve, nivelin e përgatitjes të teknikëve që jepnin mësim, pajisjen e tyre dhe të nxënësve

⁶⁹ *Po aty*, viti 1954, dos. 173, fl. 32-36.

⁷⁰ *Po aty*.

⁷¹ *Po aty*.

⁷² *Po aty*, dos. 173/1, fl. 7-8.

me bazë materiale etj. Në vitin shkollor 1960-1961 në shkallë vendi, ekzistonin 31 shkolla të rezervave të punës dhe numri i nxënësve që i mbaruan ato ishte 2.205⁷³. Kurse në rrethin e Fierit, u çelën 9 shkolla të ulëta profesionale (profil pambukun ose duhanin), pranë shkollave 7-vjeçare në këto qendra, si: “N.B.SH. Çlirim, ku merrnin pjesë 30 nxënës, Libofshë (20 nxënës), Koop. e Bashkuar “Enver Hoxha”(35 nxënës), Roskovec (25 nxënës), Koop. e Bashkuar Suk (20 nxënës), Koop. e Bashkuar Frakull e Madhe (25 nxënës), Ballsh (25 nxënës), N.B.SH. Levan (20 nxënës) dhe Koop. e Bashkuar Seman (25 nxënës)”⁷⁴.

Megjithatë, ritmi i ngritjes tekniko-profesionale të punëtorëve, në krahasim me kërkesat e prodhimit dhe nevojat për punëtorë me kualifikim të lartë, nuk ishte ende ai i duhuri. Kishte mospërputhje midis shkallës së kualifikimit të punëtorëve dhe vendit të punës. Kjo veç të tjerave, shpjegohej edhe me interesimin e pakët të punëtorëve me shkallë kualifikimi të ulët. Për mungesë punëtorësh me kualifikim të lartë, ata punonin në procese pune të këtyre shkallëve dhe shpërbleheshin sipas punës që bënin. Kjo situatë nuk i motivonte ata për të ngritur shkallën e kualifikimit. Pra, ekzistonte një shpërpjesëtim që nga viti në vit, ndonëse erdhi duke u zbutur, mbeti një problem në të ardhmen.

Sidoqoftë niveli tekniko-profesional i punëtorëve në vitet 1945-1960, si rezultat i masave që mori shteti u rrit ndjeshëm. Pas vitit 1960, numri i punëtorëve të kualifikuar përbënte 48.6 për qind të numrit të përgjithshëm të punëtorëve⁷⁵. Të gjitha këto ndikuan në zhvillimin ekonomik e shoqëror të rajonit.

Në vitet 1945-1960, në rrethin e Fierit, përveç kurseve me orientim tekniko-bujqësor, një kujdes i veçantë iu kushtua edhe hapjes së kurseve për profesione të ndryshme, siç ishin ato për drejtim administrativ financiar, statistikor-financiar, për daktilografistë, për rrobaqepësi, për amvisëri, për muratorë, etj, nevojë kjo e ngutshme e shoqërisë për zhvillimin ekonomik-shoqëror.

Ato luajtën një rol të rëndësishëm në ndryshimin e mënyrës së jetesës dhe në ngritjen arsimore e kulturore të popullit, veçanërisht femra në fshat. Një ndihmesë të madhe në organizimin dhe masivizimin e

⁷³ *Vjetari Statistikor i RPSH*, Tiranë 1962, f. 259-278. Kapitulli XIII - Arsimi dhe Kultura: Të dhënat e vitit 1961-1962.

⁷⁴ *ASHVL*, Fondi 117, viti 1961, dos. 178, fl. 2.

⁷⁵ Kahreman Ylli, “Puna me kuadrin (Mbi kuadrin arsimor)”, në: *Arsimi Popullor*, Nr.1, viti 1961, f. 12-32.

kurseve dha organizata e grave, sidomos mësueset që punonin në fshatra. Ato me propagandën, që bënë nëpër shkolla dhe shtëpi arritën të sensibilizonin rëndësinë e këtyre kurseve për kohën.

Në rritjen e numrit të punonjësve të kualifikuar, një rol të rëndësishëm, luajtën shkollat e mesme profesionale dhe në mënyrë të veçantë, Teknikumi Bujqësor "Rakip Kryeziu" (1952) si shkolla e parë e mesme profesionale në rrethin e Fierit. Nxënësit që nuk vazhduan studimet në shkollat e larta, punuan së bashku me punëtorët si teknikë të mesëm, siç quhej atëherë. Me përvojën e tyre, ata dhanë një ndihmesë të madhe për aftësimin tekniko-profesional të punëtorëve të rinj të pakualifikuar dhe, për ngritjen e mëtejshme tekniko-profesionale të punëtorëve me kualifikim të ulët.

Pas vitit 1960, në qytetin e Patosit, pranë shkollës 12-vjeçare, u hap Teknikumi i naftës me 60 nxënës, që përgatiste teknikë të mesëm për mekanikë. Një vit pas hapjes, numri i nxënësve shkoi në 244 veta, në katër specialitete, dy degë: mekanikë dhe gjeologë⁷⁶. Personeli mësues dhe specialistë inxhinierë, vinin nga Kuçova⁷⁷.

Duke përfunduar mund të thuhet se parë nga këndvështrimi i rezultateve sasiore, të cilat ishin të konsiderueshme, zhvillimet arsimore të viteve 1945-1960 i ndihmuan procesit të ndryshimeve të shoqërisë shqiptare në përgjithësi dhe asaj fierake në veçanti. Me gjithë kufizimet dhe orientimin lindor që mori shkolla niveli i arsimimit erdhi në rritje, duke ofruar më tepër mundësi për shtresat e ndryshme të popullsisë.

S u m m a r y

ASPECTS FROM THE MASSIVISATION OF THE EDUCATION IN THE DISTRICT OF FIER (1946-1960)

While attempting to discuss and analyse some aspects of the massivisation of education in the district of Fier (1946-1960), it is the opportunity to present some conclusions:

- The essential conclusion of the study is that the development of the education in the district of Fier, it was commensurate to the lows, the official decisions, and educational programs plans of the development of education in a national level. Also in

⁷⁶ *Historiku i arsimit në rrethin ...*, f. 194.

⁷⁷ *Po aty*.

the profile of the educational development in the district of Fier could not be circumvented the regional dimension, which has been configured from factors such as: geography, lowland and hilly terrain of the region, the educational tradition and the great desire of the population to acquire new knowledge, the level of the educational staff, the creation of a climate of sympathy and respect for the newcomers, the pace of the economy of an agricultural nature, without neglecting the tendencies of the industrial-agricultural development of the Fier district during the post WWII period.

- As in rest of Albania also in the district of Fier, the education was in the focus of the communist government. The Albanian state supported financially the whole educational system, the training and qualification of pedagogical personnel, the increase of the educational and didactic equipment etc. All the education was in the hands of the communist state and entirely controlled by it.

- The Educational Reform proclaimed in the 17th of august 1946 and implemented initially in academic year 1946-1947, created the obligatory frame of the new educational system in Albania. It included: free of charge education, general and obligatory (elementary), unique education (organic bounding between all the levels of education and even in the whole republic), equal education between males and females, laic education in the native language etc. In the country it was prohibited the existence of the private schools and religious. The education became public. In the meantime in Fier district, as in the rest of country, the school besides the educational training it took a role in the ideological and political education for the children and the youth of Fier.

- In the second phase of the educational development (1949-1955), in the district of Fier, were consolidated the main links of the new educational system, the elementary school, 7-year school, the general high school and the professional one. The school system in the district of Fier took full physiognomy during this period. It extended the network of erected schools in every village, or in a centre that covered 2-3 nearby villages. For the first time in the history of education in Fier it became a reality the implementation of the obligatory elementary school. It began the inclusion of the children in the preschool institutions and in the end of this period there is a considerable expansion of such institutions. The 4-year obligatory elementary education was fulfilled almost completely, creating conditions for full development of the 7-year unique school. With the decree of the Law of 1952, it was achieved to make obligatory the 7-year education for all the children between the ages of 7 until 16. The obligatory 7-year education it began to be fulfilled in the district of Fier during the academic year 1952-1953. During this academic year it could be counted 116 elementary schools with 11498 pupils and 18 7-year schools with 1377 pupils.

- In this period were opened low technical-professional schools, the first agriculture high school (Teknikumi Bujqësor “Rakip Kryeziu”) in 1952 and general high school “Janaq Kilica” in 1956, in which were trained qualified workmen, techniques personnel and middle specialists. A portion of them pursued university education in the fields of economy, industry, education, culture, constructions, army etc.

- As a conclusion seen from the viewpoint of the quantitative results, which were important, the educational developments of the first two post war decades assisted the development of the Albanian society in general and of Fier in particular. Considering all the limitations, the scale of education was increased by offering more chances for all the strata and in particular to the new generations.